



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION




**Emri i Biznesit:** BESNIK AD. BERISHA B.I.  
**Emri tregtar:** N.SH. "FESTINA"  
**NUI:** 811311795  
**Pronari:** Besnik Berisha  
**OSHMA:** Radio dhe TV Festina  
**Adresa:** Rr/Driton Islami, p.n., Ferizaj

**Emri i Biznesit:** LUMNIJE BERISHA B.I.  
**Emri tregtar:** N.SH. "FESTINA"  
**NUI:** 811385948  
**Kandidati për pronar:** Lumnije BERISHA  
**OSHMA:** Radio dhe TV Festina  
**Adresa:** Rr/ Driton Islami, p.n., Ferizaj

### VENDIM

për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së Radio dhe TV Festina, me seli në  
Komunën e Ferizajit



### Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio dhe TV Festina janë Ofrues të Shërbimeve Mediale me mbulim lokal, të licencuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave për transmetim tokësorë të programeve, në gjuhën shqipe dhe me seli në komunën e Ferizajit.
3. Më datën 25 shkurt 2021, pronari i Radio dhe TV Festina ka dorëzuar në zyrën e KPM-së një kërkesë, përmes së cilës ka kërkuar miratim për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës nga biznesi individual Besnik AD. Berisha B.I., me Numër Unik Identifikues (NUI) 811311795 (emri tregtar N.SH. "FESTINA") dhe me pronar z. Besnik Berisha, tek, biznesi individual Lumnije Berisha B.I. me Numër Unik Identifikues 811385948 (emri tregtar N.SH. "FESTINA") dhe me pronare znj. Lumnije Berisha (bashkëshortja e pronarit aktual).

### Arsyetim


4. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "licencat nuk mund të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së".
5. Neni 15, pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: "Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të

interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”

6. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: “KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”
7. Me anë të kërkesë për ndryshimin e pronësisë së Radio dhe TV Festina, pronari aktual ka deklaruar se arsye për këtë ndryshim është inkuadrimi i tij në jetën politike, respektivisht ushtrimi i funksioneve në organet ekzekutive të një partie politike.
8. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri, përmes një deklarate se pjesë e kërkesës, ka shprehur gatishmëri që ofrimin e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale për publikun do ta bëjë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
9. Duke u bazuar në gatishmërinë e shprehur të kandidatit për pronar të ri për të punuar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, si dhe bazuar në deklarinë e pronarit të deritanishëm se ai është inkuadruar në aktivitete politike, e cila situatë sipas Ligjit për KPM-në, paraqet pengesë që njëkohësisht të jetë edhe pronar i licencës, Komisioni vlerëson se ndryshimi i pronësisë së Radio dhe TV Festina është në interes të publikut.
10. Komisioni vlerëson se, kërkesa është bërë në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

### Vendim

11. Komisioni në takimin e tij të mbajtur me datën 16 mars 2021, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e pronësisë së Radio dhe TV Festina dhe bartjen e licencës nga biznesi individual Besnik AD. Berisha B.I., me Numër Unik Identifikues (NUI) 811311795 (emri tregtar N.SH. “FESTINA”) dhe me pronar z. Besnik Berisha, tek, biznesi individual Lumnije Berisha B.I. me Numër Unik Identifikues 811385948 (emri tregtar N.SH. “FESTINA”) me pronare znj. Lumnije Berisha (bashkëshortja e pronarit aktual).
12. Përveç ndryshimit të pronësisë të Radio dhe TV Festina nuk do të ketë në ndryshime në pjesët tjera të Licencës, si Pjesës II – Parametrave Teknik, III – Formatit të Programit dhe IV – Zonës së Mbulimit.
13. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

  
Xhevat LATIFI  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur i Mediave



16.03.2021  
datë